

PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË MONITORIMIT

JANAR-DHJETOR 2022

- Hyrje
- Relacion shpjegues
- Aneksi nr. 1 “Raporti i shpenzimeve sipas Programeve”
- Aneksi nr. 2 “Raporti i shpenzimeve të Programit sipas artikujve buxhetore”
- Aneksi nr. 3 “Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit”
- Aneksi nr. 4 “Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit”
- Aneksi nr. 5 “Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim të huaj”

Hyrje

Në zbatim të pikës 49, Kreu IV, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “*Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*”, paraqesim në mënyrë të përmbledhur procesin e monitorimit të realizimit të fondeve buxhetore të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit për vitin 2022 si në vijim:

Programet buxhetore të Ministrisë në përmbushje të politikave të tyre, kanë kryer të gjitha shpenzimet e nevojshme në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2021 “*Për buxhetin e vitit 2022*”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 “*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022*”.

EMP-të me në krye DEMP kanë realizuar monitorimin e performancës së programeve, konkretisht të politikës së programeve, objektivave, treguesve të performancës, si dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore në funksion të tyre për të gjithë artikujt përkatës.

Gjatë vitit 2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), në kuadër të monitorimit të buxhetit ka përgatitur në fund të çdo muaji evidencën e shpenzimeve korrente dhe kapitale, të rakorduara me planin e buxhetit dhe realizimin faktik të thesarit sipas SIFQ.

Ky raport përmban një analizë të detajuar për vitin 2022, lidhur me arritjen e treguesve dhe objektivave të parashikuara në programet buxhetore si më poshtë:

1. “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”
2. “Mbrojtja e Mjedisit”
3. “Administrimi i Pyjeve”
4. “Zhvillimi i Turizmit”

Në raport përshkruhen produktet e realizuara nga drejtoritë përgjegjëse të këtyre programeve në Ministri, të cilët janë përgjegjës për përmbushjen e objektivave të veçantë të parashikuar në këtë dokument. Institucionet e varësisë: Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe 4 Agjencitë Rajonale, bazuar në VKM-në nr. 568, datë 17.7.2020 të Këshillit të Ministrave *“Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”*, si dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 187, datë 15.11.2022 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”*, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 188, datë 15.11.2022 *“Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 26, datë 03.02.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”*, të ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, të cilës në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 186, datë 15.11.2022 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”*, janë organizuar 4 Agjenci Rajonale të Bregdetit në Lezhë, Durrës, Vlorë, Sarandë; Agjencia Kombëtare e Turizmit bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 122, datë 31.07.2018 *“Për disa ndryshime në Urdhrin nr.175, datë 09.12.2016” të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Turizmit”*; Agjencia Kombëtare e Pyjeve me VKM nr. 570, datë 17.07.2019 *“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”*, si dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 192, datë 18.11.2022 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”*.

Bashkëlidhur këtij raporti gjenden anekset e plotësuara të specifikuara në Udhëzim. Të dhënat janë rakorduar me planin e buxhetit dhe realizimin faktik të thesarit sipas SIFQ-it për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale në buxhetin e miratuar për vitin 2022.

Ndryshimet kryesore që kanë ndikuar në buxhetin e vitit 2022 janë si më poshtë:

- Miratim i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 1463/1 datë 2.2.2022 *“Dërgohet detajimi i fondit të veçantë për vitin 2022”*, vlera në total për MTM 1,900,000 lekë;
- Akti Normativ nr. 3, datë 12.03.2022 *“Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”*, në zbatim të cilit pakësohen shpenzime korrente në total 56,927,750 lekë dhe shpenzimet kapitale në vlerën 50,000,000 lekë;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 20.04.2022 *“Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022”*, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2022, për pagesën e studios për çështjen e anulimit të vendimit të Arbitrazhit ICSID Case No. ARB/14/26” shtohet fondi prej 65,000,000 lekë, në artikullin 602 (shpenzime operative) të Aparatit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

- Akti Normativ nr. 12, datë 29.07.2022 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”*, i ndryshuar, sipas të cilit janë pakësuar fondet e shpenzimeve korrente me 65,600,000 lekë, si edhe janë shtuar fondet e investimeve me 48,000,000 lekë;
- Akti Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”*, i ndryshuar, sipas të cilit janë pakësuar fondet për shpenzimet korrente në vlerën 38,000,000 lekë, si edhe pakësohen fondet e investimeve me vlerën 81,500,000 lekë;
- Akti Normativ nr. 19, datë 29.12.2022 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”*, i ndryshuar, sipas të cilit pakësohen fondet e investimeve me vlerën 8,000,000 lekë;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 898, datë 29.12.2022 *“Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisve të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”*, sipas të cilit janë shtuar fondet për shpenzimet korrente (llogaria 606) me vlerën 12,600,000 lekë.

Realizimi i Buxhetit të MTM sipas Programeve Buxhetore

Në 000 lekë

	Plani Vjetor	Ndryshimet/ Alokimet	Plani Dhjetor 2022	Realizimi Dhjetor 2022	Realizimi në %
Planifikim, Menaxhim & Administrim	197,040	61,513	258,553	213,776	83%
Administrimi i Pyjeve	417,700	(58,361)	359,339	354,912	99%
Zhvillimi i Turizmit	773,400	(58,966)	714,434	684,336	96%
Mbrojtja e Mjedisit	561,320	(55,367)	505,953	481,705	95%
TOTALI	1,949,460	(111,181)	1,838,279	1,734,730	94%

Realizimi i Buxhetit të MTM sipas Llogarive Financiare

Në 000 lekë

	Plani Vjetor	Ndryshimet/ Alokimet	Plani Dhjetor 2022	Realizimi Dhjetor 2022	Realizimi në %
Llogaria 600-601	797,790	(90,945)	706,845	686,402	97%
Llogaria 602	540,570	(2,947)	537,623	478,175	89%
Llogaria 604	10,000	(2,960)	7,040	3,557	51%
Llogaria 605	20,000	-	20,000	16,975	85%
Llogaria 606	360	16,171	16,531	15,428	93%
Llogaria 230-231 (financim i brendshëm)	580,740	(30,500)	550,240	534,196	97%
TOTALI	1,949,460	(111,181)	1,838,279	1,734,730	94%

- **Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore (600-601)** për periudhën 12 mujore janë realizuar në masën 97% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.
- **Shpenzimet operative (602-606)** për periudhën 12 mujore janë realizuar në masën 75% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.
- **Shpenzimet kapitale (230-231)** për periudhën 12 mujore janë realizuar në masën 97% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

1. Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Ky program ka si objektiv rritjen, forcimin dhe zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese për një planifikim, menaxhim dhe administrim të politikave dhe strategjive në fushën e mjedisit, pyjeve si dhe koordinimi i punës me të gjitha drejtoritë e politikave për kontrollin dhe zbatimin e tyre; trajnimi si një mjet strategjik për rritjen e burimeve njerëzore; hartimi dhe rritja e kontrollit mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve financiare në të gjithë strukturën e MTM-së dhe institucionet e varësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat në kuadër të procesit të integritetit. Qëllimi i politikës së programit është përmirësimi i strukturës funksionale për një menaxhim sa më efektiv të burimeve njerëzore për të krijuar një staf permanent dhe sa më të qëndrueshëm për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e mjedisit dhe turizmit.

Gjatë vitit 2022, për këtë program janë realizuar produktet dhe treguesit e performancës së synuar.

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

Në 000 lekë

Art.	Emërtimi	Plani	Ndryshimet	Plani me ndryshime	Fakti Progresiv	Realizimi në %
		Vjetor	Alokimet	2022	Dhjetor 2022	
	Planifikim, Menaxhim & Administrim	197,040	61,513	258,553	213,776	83%
600	Pagat	74,000	(1,850)	72,150	70,975	71%
601	Sigurime Shoqërore	11,500	(288)	11,213	11,213	100%
602	Shpenz. Operative	88,180	61,064	149,244	109,459	73%
605	Transferta korente të huaja	20,000	-	20,000	16,975	85%
606	Transferte tek individët	360	3,787	4,147	3,451	83%
231	Pajisje TIK	2,000	(200)	1,800	1,704	95%
231	Orendi dhe pajisje	1,000	(1,000)	0	0	0

Në programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” për 12 mujorin e vitit 2022, shpenzimet korrente dhe kapitale (investim i brendshëm) janë realizuar në nivelin 83% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Produkti “Akte ligjore dhe nënligjore” është realizuar në masën 83% përgjatë 12 mujorit të vitit 2022, kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Në shpenzime kapitale të planifikuara, projekti “Pajisje TIK”, procedurë e realizuar nga AKSHI me vlerë 1,704 mijë lekë, është realizuar në masën 95% kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Projekti “Orendi dhe pajisje” me kod M260001 është pakësuar sipas Aktit Normativ Nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”.

2. Programi “Mbrojtja e Mjedisit”

Programi i Mbrojtjes së Mjedisit mbulon sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, nëpërmjet garantimit të përputhshmërisë së veprimtarive me ndikim në mjedis me kushtet e lejeve mjedisore dhe kërkesave të legjislacionit mjedisor, përmirësimin të cilësisë së ajrit në zonat kryesore urbane; menaxhimit të integruar të mbetjeve, parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes dhe rreziqeve nga aksidentet industriale, përsheptimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjes së gazrave me efekt serë; ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, biodiversitetit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura.

Monitorimi i këtij programi kryhet për të vlerësuar përmbushjen e objektivave nëpërmjet produkteve dhe indikatorëve të përcaktuar për secilin prej tyre. Analiza vlerësuese tregon se përgjithësisht ato janë në përputhje me afatet dhe standartet e parashikuara në PBA 2022-2024.

Puna për realizimin e programit “Mbrojtja e Mjedisit” është përqëndruar në tre shtylla kryesore, që lidhen respektivisht me objektivat e përcaktuar në dokumentin e PBA-së:

1. Hartimi i legjislacionit për transpozimin e aquis së mjedisit dhe aquis të ndryshimeve klimatike.
2. Zbatimi i legjislacionit që lidhet me:
 - a) Monitorimin e mjedisit nga stafi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për fushën e cilësisë së ajrit, zhurmave, cilësisë së ujërave, mbetjeve, biodiversitetit.
 - b) Shqyrtimin dhe miratimin e Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në mjedis dhe lejeve mjedisore.
3. Inspektime kontrolli për aktivitetet industriale dhe veprimtari prodhuese, lidhur me shkarkimet në ajër, menaxhimin e mbetjeve industriale, urbane, si dhe zhurmave.

Objektivi i parë lidhet me sigurimin e mbrojtjes së mjedisit në një nivel të lartë, janë hartuar akte ligjore dhe nënligjore që transpozojnë direktiva, rregullore dhe vendime të BE për fushën e mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike. Në kuadër të procesit të Integrimit Evropian të vendit, çdo vit rishikohet PKIE 3-vjeçare për transpozimin e aquis së BE-së dhe hartohen raporte periodike 3-mujore për zbatimin e saj, përfshirë kontributin për nënkomitetin BE-Shqipëri, KSA dhe planin e veprimtari për adresimin e rekomandimeve të progres raportit të KE. Janë hartuar dokumente

strategjik dhe plan veprimi në zbatim të politikave për arritjen e objektivave kombëtare në fushën e menaxhimit të mbetjeve, si dhe plane veprimi me aktivitete konkrete për arritjen e tyre.

Objektivi i dytë lidhet me përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare ndaj mjedisit dhe klimës. Janë hartuar raporte kombëtare për zbatimin e detyrimeve kombëtare sipas kërkesave nga Sekretariatet e Konventave për konventat që mbulohen nga Drejtoria e Mjedisit, Ndryshimeve Klimatike dhe Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura; në kuadër të integritetit evropian janë përgatitur raportimet në kuadër të takimeve të nënkomiteteve BE-Shqipëri për mjedisin dhe Komitetin e Stabilizim Asocimit.

Objektivi i tretë lidhet me kryerjen e raporteve të monitorimit të cilësisë së ajrit, zhurmave e ujërave urbane, të cilësisë së ujërave në lumenj, liqene, dete dhe laguna, të monitorimit të treguesve në pyje dhe biodiversitet dhe të treguesve të shkarkimit e transferimit të ndotësve dhe raporti vjetor i gjendjes në mjedis. Është realizuar grumbullimi i të dhënave nga subjektet private e publike për regjistrin e shkarkimeve e transferimit të ndotësve. Vazhdon procesi i validimit dhe kontrollit të të dhënave dhe vazhdon evidentimi i subjekteve në regjistrin e transfertave të mbetjeve të rrezikshme dhe të parrezikshme. Janë shqyrtuar dosjet e aplikimit për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Janë shqyrtuar dosjet e lejeve të mjedisit të tipit A dhe B. Është bërë raportimi dhe publikimi i aktiviteteve të AKM-së në vijimësi.

Gjatë vitit 2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit janë kryer 1215 inspektime për parandalimin e përqendrimit të shfrytëzimit pa kriter të burimeve ujore, të ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të cdo lloji; 1291 dosje të shqyrtuara për përfitimin e lejeve të mjedisit; 1135 dosje të shqyrtuara për VNM; janë ngritur 71 stacione monitorimi për zhurmat urbane në qytetet kryesore; janë marr 268 kampione për menaxhimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore; janë nsdërtuar 7 harta për Raportin e Gjendjes në Mjedis, 40 harta të Paraqitjes Hapësinore të guroreve të pajisura me leje mjedisore si edhe harta të tjera mjedisore.

Transparencë në procesin e Lejeve Mjedisore

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit e ka bërë pjesë funksionale të punës së saj konsultimin me publikun;
- Kriteret për aplikim janë të gjitha online dhe të aksesueshme për aplikuesit;
- Subjektet kontrollojnë nëpërmjet QKL të gjitha procedurat, të cilat janë online;
- Çdo leje mjedisore publikohet online dhe publikohen për 20 ditë të gjitha projektet e detajuara me vendndodhjen, qëllimin e detajet teknike përkatëse.

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

Në 000 lekë

Art	Emërtimi	Plani	Ndryshimet	Plani me ndryshime	Fakti Progresiv	Realizimi në %
		Vjetor	Alokimet	Dhjetor 2022	Dhjetor 2022	
	Mbrojtja e Mjedisit	561,320	(55,367)	505,953	481,705	95%
600	Pagat	272,500	(52,813)	219,688	208,935	95%
601	Sigurime Shoqërore	45,100	(9,128)	35,973	35,005	97%
602	Shpenz. Operative	113,720	(8,436)	105,284	100,383	95%
604	Të tjera Transferta Brendshme	10,000	(2,960)	7,040	3,557	51%
606	Transferim tek individët	-	3,914	3,914	3,818	98%
18BF301	Vendepozitime te rehabilituara	50,000	-	50,000	49,831	100%
18BG705	Fire Prep-kosto lokale	9,200	(3,500)	5,700	5,700	100%
18BH001	Plastic Buster Masa pilote te zbatuara-kosto lokale	800	-	800	800	100%
18CH501	TUNE-UP kosto lokale	1,500	-	1,500	1,500	100%
18BH002	MPA-Engage (IPA) Inereg Med	2,500	3,500	6,000	6,000	100%
18BH001	Plastic Buster-Masa pilote te zbatuara -TVSH	200	430	630	627	99%
18BH101	Sistemi i ngritur per parandalimin e mbetjeve detare - TVSH	1,230	-	1,230	1,055	86%
18BH301	SANE 27 Raporte performance te hartuara - tvsh	800	-	800	591	74%
M260401	TVSH-Pershtatja me ndryshimet Klimaterike ne fushen e menaxhimit nderkufitar te riskut te permbytjeve ne Ballkanin Perendimor - GIZ	615	-	615	615	100%
18BE907	Hartim Projekti "Rikonstruksion i Godines se AKM "	-	2,160	2,160	2,160	100%
M260069	Blerje pajisje per matjen trashesise se qeseve plastike	-	1,140	1,140	1,107	97%
18BF602	Pajisje dhe pjese kembimi per 7 stacionet e monitorimit te ajrit	0	37,480	37,480	37,356	99%

18BF303	Rehabilitimi i mbetjeve urbane (Memaliaj, Tepelene, Fusharrez)	40,000	(40,000)	0	0	0
18BG704	Kosto Lokale- IPA ekonomia qarkulluese	1,000	(1,000)	0	0	0
18BG704	TVSH- IPA ekonomia qarkulluese	12,155	(12,155)	0	0	0

Në programin “Mbrotjtja e Mjedisit” për vitin 2022 shpenzimet korrente janë realizuar në nivelin 95% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në nivelin 97% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2022.

Produkti “Akte ligjore dhe nënligjore, dokumenta strategjike” është realizuar në masën 96% përgjatë vitit 2022, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “Inspektime të kryera” është realizuar në masën 94% përgjatë vitit 2022, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “Raporte monitorimi” është realizuar në masën 94% përgjatë vitit 2022, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “Dosje të shqyrtuara” është realizuar në masën 95% përgjatë vitit 2022, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

- Lidhur me projektet me financim të brendshëm, investimi “Venddepozitime të rehabilituara” është kontratë 3 vjeçare në vazhdim, ku për vitin 2022 është realizuar projekti dhe likuidimi i vlerës përkatëse në masën 100%;

- Blerje pajisje për matjen trashësisë së qeseve plastike është realizuar në masën 97% në kuadër të kryerjes së inspektimeve në subjektet prodhuese dhe tregtuese për qeset plastike nga AKM dhe Agjencitë Rajonale të saj, në zbatim të ndryshimeve ligjore “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;

- Hartim projekti “Rikonstruksioni i godinës së AKM-së”, është realizuar në masën 100%;

- Projekti “Pajisje dhe pjesë këmbimi për 7 stacionet e monitorimit të ajrit” të AKM, është shtuar sipas Aktit Normativ nr.12, datë 29.07.2022, pasi gjendja aktuale e stacioneve të ajrit nuk ishte në kushtet optimale për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe për rrjedhojë Agjencia Kombëtare e Mjedisit kërkoi një ekspert të kualifikuar me qëllim inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes së moduleve dhe pajisjeve të tjera pjesë të Stacioneve të Monitorimit të Ajrit Urban. Pas realizimit të procedurës së prokurimit dhe zbatimit të kontratës, projekti është realizuar në masën 99%;

-Është pakësuar TVSH dhe kosto lokale e projektit “IPA- *Ekonomia Qarkulluese*” sipas shkresave të MFE nr. 5040/1, datë 7.4.2022 dhe nr. 5456/1, datë 15.07.2022 dhe sipas Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022;

-Projekti “*Rehabilitimi i mbetjeve urbane (Memaliaj, Tepelenë, Fushëarrëz)*” është pakësuar fondi sipas Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, pasi nuk mund të realizohej referuar VKM nr.112 datë 02.03.2022 “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të MTM-së*” si dhe bazuar në Urdhrin nr. 46 datë 01.02.2022, ku projektet e studimit të mbetjeve do të dorëzohen për administrim dhe zbatim pranë bashkive përkatëse.

❖ Projektet në programin e mjedisit janë të renditura si më poshtë:

- Projekti “*Masa pilote të zbatuara*”, kosto lokale është realizuar 100% kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022 dhe TVSH është realizuar në masën 99% kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022;
- Projekti “*Tune – Up*”, kosto lokale është realizuar 100% ndaj fondeve të planifikuara për vitin 2022;
- Projekti “*Sistem i ngritur për parandalimin e mbetjeve detare*”, TVSH është realizuar në masën 86% ndaj fondeve të planifikuara për vitin 2022;
- Projekti “*Raporte performace të hartuara SANE 27*”, TVSH është realizuar në masën 74% ndaj fondeve të planifikuara për vitin 2022;
- Projekti “*Përshtatja me ndryshimet Klimaterike në fushën e menaxhimit ndërkufitar të riskut të përmytjeve në Ballkanin Perëndimor-GIZ*”, TVSH është realizuar në masën 100% ndaj fondeve të planifikuara për vitin 2022;
- Projekti “*Fire Prep*”, kosto lokale është realizuar në masën 100% kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022;
- Projekti “*MPA-Engage (IPA) Intereg Med*” është realizuar në masën 100% fondeve të planifikuara për vitin 2022.

3. Programi “Administrimi i Pyjeve”

Programi i Administrimit të Pyjeve përfshin hartimin e politikave për menaxhimin e qëndrueshëm të ekosistemeve, duke promovuar zhvillimin e një ekonomie të gjelbër, koordinimin në nivel qendror, rajonal dhe lokal të praktikave më të mira në drejtim të menaxhimit të burimeve natyrore duke rritur eficiencë në përdorimin e tyre, përdorimin e metoda dhe mjete miqësore me mjedisin në planet operationale e të zbatimit. Automatizimi i bazës së të dhënave për regjistrin pyjor dhe digjitalizimi i hartave, mbështetjen e kërkimit, zhvillimit teknologjik e inovacioneve në pyje, dhënia e shërbimit këshillimor dhe aftësimin e kapaciteteve të personelit pyjor dhe administrative lokal, harmonizimi ligjor e nënligjor, bashkëpunimi institucional me struktura të tjera të interesuara për menaxhimin e qëndrueshëm e ruajtjen e biodiversitetit.

Monitorimi i këtij programi kryhet për të vlerësuar përmbushjen e objektivave nëpërmjet produkteve dhe indikatorëve të përcaktuar për secilin prej tyre. Analiza vlerësuese tregon se përgjithësisht ato janë në përputhje me afatet dhe standartet e parashikuara në PBA 2022-2024.

Lidhur me treguesit e performancës, gjendja paraqitet si vijon:

- Gjatë vitit 2022 në zonat e mbrojtura kanë hyrë 4,648,736 turistë, kundrejt 4,295,998 turistëve në vitin 2021;
- Gjatë vitit 2022 janë kryer 24,600 monitorime për vlerësimin e biodiversitetit dhe vlerave natyrore në Zonat e Mbrojtura, kundrejt 16,570 monitorimeve të kryra në vitin 2021;
- Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar 371 orë mësimore për ndërgjegjësimin dhe informimin mbi Zonat e Mbrojtura, kundrejt 410 orëve mësimore të zhvilluara gjatë vitit 2021.

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

Në 000 lekë

Art	Emërtimi	Plani	Ndryshimet	Plani me ndryshime	Fakti progresiv	Realizimi në%
		Vjetor	Alokimet	Dhjetor 2022	Dhjetor 2022	
	Administrimi i Pyjeve	417,700	(58,361)	359,339	354,912	99%
600	Pagat	217,200	(1,618)	215,582	214,353	99%
601	Sigurime Shoqërore	42,250	(4,869)	37,381	35,992	96%
602	Shpenz. Operative	79,750	(14,975)	64,775	63,344	98%
606	Transferim tek individët	-	6,500	6,500	6,319	97%
18BE611	Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore - Eco Park Ulza	48,500	(27,500)	21,000	20,888	99%

18BE612	Hartimi i planit te integruar te menaxhimit “Parku Kombetar Mali i Dajtit”	0	14,100	14,100	14,016	99%
18BE610	Ndertimi i nje qendre multifunkionale ne zonen e re te mbrojtur te Lumit Vjosa	30,000	(30,000)	0	0	0

Në programin “Administrimi i Pyjeve” për vitin 2022, shpenzimet korrente janë realizuar në nivelin 98% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2022.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për vitin 2022 janë realizuar në masën 99% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2022.

Produkti “Raporte monitorimi në Zonat e Mbrojtura” është realizuar në masën 100% përgjatë vitit 2022, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “Objekte të administruara nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura” është realizuar në masën 100% përgjatë vitit 2022, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “Inventarizim dhe kadastër e kryer” është realizuar në masën 93% përgjatë vitit 2022, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “Plane menaxhimi per pyjet” është realizuar në masën 90% përgjatë vitit 2022, kundrejt fondeve të totale të planifikuara.

Lidhur me projektet e shpenzimeve kapitale “Hartimi i planit të integruar të menaxhimit “Parku Kombëtar Mali i Dajtit”, i cili është realizuar në masën 99%. Gjithashtu, edhe projekti “Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore - Eco Park Ulza” është realizuar në masën 99% kundrejt fondeve të planifikuara. Projekti “Ndërtimi i një qendre multifunkionale në zonën e re të mbrojtur të Lumit Vjosa” është pakësuar sipas shkresave të MFE nr. 8657/1, datë 19.05.2022 dhe nr.17555/1, datë 29.09.2022 dhe sipas Aktit Normativ nr.17, datë 1.12.2022.

Agjencia Kombëtare e Pyjeve: Për periudhën Janar –Dhjetor 2022 ka shpenzuar rreth 92% të buxhetit vjetor të rishikuar ose 38,243,441 lekë. Për vitin 2022 nga buxheti i akorduar për shpenzimet e personelit janë përdorur 29,216,146 lekë ose rreth 94% e totalit të zërit 600, ndërsa nga buxheti për shpenzimet operative janë shpenzuar 9,027,295 lekë ose rreth 85% e totalit të zërit 602. Gjithashtu, për vitin 2022 Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka realizuar një nga produktet e saj më të rëndësishme sic është botimi i Inventarit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave. Shpenzimet për

realizimin e këtij produkti kanë arritur në shumën prej 539,400 lekë ose 5.4% të fondit në artikullin 602.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura: Për periudhën janar- dhjetor 2022 ka realizuar 99% të fondeve të buxhetit total të rishikuar. Gjatë vitit 2022 ka realizuar në masën 99% shpenzimet për personelin, në vlerën 220,518,237 lekë; edhe shpenzimet korrente janë realizuar në masën 99%, në vlerën 48,886,038 lekë. Shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 99%, në vlerën totale 63,304,019 lekë.

4. Programi “Zhvillimi i Turizmit”

Programi i Zhvillimit të Turizmit mbështetet në strategjinë sektoriale të turizmit, planin e saj të veprimit, si dhe të masave në strategjitë ndërsektoriale. Programi i Zhvillimit të Turizmit synon një turizëm të qëndrueshëm në kohë, social, mjedisor dhe ekonomik që arrihet nëpërmjet:

1) Përmirësimit dhe rishikimit në vazhdimësi të kuadrit ligjor për turizmin me fokus harmonizimin e tij me politikat e qeverisë; 2) Përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet incentivave ligjore, fuqizimit të bashkëpunimit publik-privat; 3) Sistemit të licencimit, klasifikimit dhe çertifikimit të sipërmarrjeve turistike me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe mbrojtjen e konsumatorit, si dhe monitorimit të sipërmarrjeve turistike; 4) Diversifikimit të produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjeter etj. Objektivi për “*Diversifikimin e ofertës turistike duke synuar praninë e turistëve gjatë gjithë vitit*” rezulton përgjithësisht i realizuar. Me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor, që lidhet direkt ose indirekt me zhvillimin e sektorit të turizmit, gjatë vitit 2022 janë hartuar akte ligjore e nënligjore, janë kryer inspektime të vijës bregdetare për evidentimin e zhvillimeve më të fundit duke nisur nga çështjet e ndërtimeve të reja, ndotjet mjedisore, përdorimin e hapësirave publike, kriteret për stacion plazhi. Për mbarëvajtjen e sezonit veror është intensifikuar puna për monitorimin në terren. Është siguruar pjesëmarrja në panaire ndërkombëtare, si dhe janë organizuar aktivitete të tjera promovuese.

Gjatë vitit 2022, totali i kontratave të lidhura për përdorimin e hapësirës për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit është 1252 kontrata, nga të cilat 442 janë lidhur në sezonin turistik aktual, pas dorëzimit të çertifikatës së vrojtuesit nga subjektet e interesuara dhe kemi 810 kontrata ekzistuese nga sezoni turistik 2021 me afat 2-5 vjet.

Gjatë vitit 2022, në vendin tonë kanë hyrë 7,543,817 turistë, duke e bërë vitin 2022 më të suksesshmin.

BASHKIA	KONTRATA		
	<i>Kontrata të lidhura pas dorëzimit të certifikatës së vrojtuesit</i>	<i>Kontrata ekzistuese të lidhura në sezonin 2021 me afat 2-5 vjet</i>	TOTAL
SHKODËR	13	57	70
LEZHË	35	96	131
DURRËS	98	128	226
KAVAJË	31	77	108
RROGOZHINË	9	51	60
DIVJAKË	5	8	13
POGRADEC	14	39	53
FIER	4	69	73
VLORË	97	89	186
HIMARË	63	127	190
SARANDË	73	69	142
TOTAL	442	810	1252

AKB, në funksion të lidhjes së kontratës për sezonin turistik 2022, ka kontaktuar të gjithë subjektet që kanë marrë miratimin përfundimtar nga GTSHA për t'u paraqitur për nënshkrimin e kontratës, pasi të jenë pajisur me vrojtues plazhi të certifikuar.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit në mbështetje të katër bashkive bregdetare

Agjencia Kombëtare e Bregdetit është angazhuar përgjatë sezonit veror në mbështetje të katër bashkive Durrës, Kavajë, Himarë, Sarandë në procesin e pastrimit të vijës bregdetare, duke dyfishuar frekuencën e pastrimit të plazheve. Kjo mbështetje ka nisur që në 15 qershor dhe ka vijuar deri më 15 shtator. Për periudhën Janar- Dhjetor 2022, përgjatë vijës bregdetare janë bërë 1138 monitorime dhe 798 inspektime nga të cilat janë vendosur 219 masa administrative (91 gjoba dhe 128 paralajmërime). Produkti “*Bashki të mbështetura për pastrimin e bregdetit*”, është projekt i ri i vitit 2022 për zbatim në 4 bashki në vlerën 103,700,000 lekë, i cili është realizuar plotësisht.

Agjencia Kombëtare e Turizmit

Promovimi i Shqipërinë si një “destinacion turistik” në pellgun e Mesdheut, Evropë dhe në mbarë botën mbetet në fokus të zhvillimit të turizmit. Për të përmbushur këtë detyrë, institucioni aplikon një gamë të gjerë mjeteve dhe metodash. Më të rëndësishme janë organizimi dhe menaxhimi i pjesëmarrjes së Shqipërisë në panairë ndërkombëtare turistike, promovimi on-line, botimi i materialeve promovuese, udhëtime familjarizuese me tur-operatorë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe PRESS, si edhe aktiviteteve të tjera. Nxitja dhe promovimi i turizmit në familje si një burim gjenerues i të ardhurave në turizëm merr një tjetër prioritet për zhvillimin e turizmit.

Gjatë viteve të fundit, AKT-ja ka qenë aktive në pjesëmarrjen e saj në panairë të udhëtimit turistik të tilla si ITB Berlin, W.T.M. Londër, Bit Milano, etj.

Materiale Promocionale

Fushatë e Integruar e Marketingut për Promovimin e Turizmit Shqiptar

Spote promovuese

Panairi New Deal – Londër

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

Art	Emërtimi	Plani	Ndryshimet	Plani me ndryshime	Fakti Progresiv	Realizimi në %
		Vjetor	Alokimet	Dhjetor 2022	Dhjetor 2022	
	Zhvillimi i Turizmit	773,400	(58,966)	714,434	684,336	96%
600	Pagat	116,000	(17,900)	98,100	93,926	96%
601	Sigurime Shoqerore	19,240	(2,481)	16,759	16,003	95%
602	Shpenz. Operative	258,920	(40,600)	218,320	204,987	94%
606	Transferim tek individët	-	1,970	1,970	1,840	93%
18BE902	Mbeshtetje Financiare Projektit BERZH	178,740	(740)	178,000	178,000	100%
M260404	Fondi për Zhvillimin e Turizmit	75,760	40,150	115,910	109,584	95%
18BE907	Hartim Projekti "Rehabilitimi i shesheve dhe rrugëve kryesore në afërsi të pikave doganore Shqiptare"	24,240	(8,000)	16,240	14,976	92%
18CH001	Kosto Lokale Regjistrimi		8,107	8,107	8,107	100%

18CH401	TVSH - Due Mari	9,000	(3,000)	6,000	5,150	86%
18BE903	Permiresimi Infrastruktures dhe kthimi i Parkut Natyror "Syri Kalter" ne destinacion Eco-Turistik	50,000	(356)	49,644	49,288	99%
18BE905	Kosto – lokale Strategjia e Biodiversitetit dhe Turizmit per te mbrojtur gjitarët e detit/BioTours	2,000	-	2,000	-	0%
18BE905	Tvsh - Strategjia e Biodiversitetit dhe Turizmit per te mbrojtur gjitarët e detit/BioTours	1,000	-	1,000	106	11%
18CH002	Kosto Lokale Reglports I	0	2,000	2,000	1,986	99%
M260404	Fondi per zhvillimin e turizmit (fond i transferuar per Bashkine Berat)	0	384	384	384	100%
18CH401	Kosto Lokale-Due Mari	18,500	(18,500)	0	0	0
18BE906	Sinjalistika pergjate bregdetit	20,000	(20,000)	0	0	0

Në programin “Zhvillimi i Turizmit” për vitin 2022, shpenzimet korrente janë realizuar në nivelin 95% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në nivelin 97% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Produkti “*Akte ligjore dhe nënligjore*”, është realizuar në masën 98% përgjatë vitit 2022, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “*Monitorime të kryera përgjatë gjithë vijës bregdetare*”, është realizuar në masën 94% përgjatë vitit 2022, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “*Turizëm i promovuar*”, është realizuar në masën 90% përgjatë vitit 2022, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “*Bashki të mbështetura për pastrimin e bregdetit*”, është projekt pilot i vitit 2022 për zbatim në 4 bashki në vlerën 103,700,000 lekë (fond i rishikuar), nga të cilat është realizuar në masën 100% përgjatë vitit 2022, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

❖ Projektet në programin e turizmit janë të renditura si më poshtë:

- Projekti “*Mbështetje Financiare Projekti BERZH*”, është realizuar 100% ndaj fondeve të planifikuara për vitin 2022;
- Për projektin “*Due Mari*”, TVSH është realizuar në masën 86% kundrejt fondeve totale të planifikuara për vitin 2022;
- Projekti “*Përmirësimi i Infrastrukturës dhe kthimi i Parkut Natyror “Syri i Kaltër” në destinacion eko-turistik*”, është realizuar në masën 99% kundrejt fondeve totale të planifikuara për vitin 2022.
- Projekti “*Strategjia e Biodiversitetit dhe Turizmit për të mbrojtur gjitarët e detit/ BioTours*”, projekt i Agjencisë Kombëtare të Turizmit, TVSH është realizuar në masën 11%, ndësa kosto lokale është nuk realizuar, pasi projekti është ndërprer për një periudhë të pacaktuar, për shkak të bllokimit të rifinancimit nga ana e programit IPA Itali - Shqipëri - Mali i Zi për shkak të projektit Due Mari (projekte të lidhura);
- Projekti “*Hartim Projekti Rehabilitimi i shesheve dhe rrugëve kryesore në afërsi të pikave doganore Shqiptare*”, është realizuar në masën 92% kundrejt fondeve të planifikuara;
- Projekti “*REGLPORT*”, kosto lokale e Agjencinë Kombëtare të Bregdetit është realizuar në masën 99% dhe për arsye të kryerjes së pagesave përfundimtare të projektit është celur fond për të njëjtin projekt në aparatin e MTM-së, e cila është realizuar në masën 100%;
- Projekti “*Fondi për zhvillimin e turizmit*” (M260404) në vlerën 384,000 lekë, është fond i transferuar për Bashkinë Berat, si subjekt fitues i thirrjes për projektet e turizmit.
- Projekti “*Sinjalistika përgjatë Bregdetit*”, është pakësuar sipas Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022.
- Kosto lokale e projektit “*Due Mari*” është pakësuar sipas shkresës së MFE nr.17555/1, datë 29.9.2022;
- Për projektin “*Fondi për Zhvillimin e Turizmit*”, janë lidhur dhe likuiduar kontratat me dy këste 30% dhe 70% për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit (procedurë me projekt-thirrje). Ky projekt është realizuar në masën 95%, pasi disa prej subjekteve fitues, janë tërhequr gjatë procedurës. Projekt- thirrjet janë publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit gjatë periudhës 24 janar-23 shkurt dhe 7 tetor-5 nëntor 2022.

Në thirrjen e parë janë shpalluar fitues 39 projekte (sipas tabelës së më poshtme), prej të cilëve 35 janë realizuar dhe 5 janë tërhequr:

Nr.	Projekti	Kontrata/ subjekti perfitues
1	Projekti "Producente nderkombetar te filmave turistike promovojne destinacionet turistike shqiptare"	Pandeli Ceco
2	Projekti "Krijimi i Identitetit korporativ & Brand Book per 4 bashki"	Ardit Koleci PF
3	Projekti "Edukimi dhe Trajnimi i hoteleve mbi promovimin e turizmit"	Klajdi Gjondedaj PF
4	Projekti "Shqiperia turstike, tregoje dhe mbroje"	Qendra "Dritare"
5	Projekti "Promovimi i turizmit mjekesor"	Endri Dullerari PF
6	Projekti "Ne zbulim te kulinarise shqiptare II"	Briken Rrozhani PF
7	Projekti "Rivitalizimi I Trashegimise Kulturore-porta kryesore e turizmit ne bashkine Permet"	Shoqata "Vjosa Explorer"
8	Projekti "Risi n' Tur"	Fabiola Duro (Innvest)
9	Projekti "All trails Albania"	Shoqata "SASH"
10	Projekti "Albania Coast from the Air"	Grid Cartels sh.p.k
11	Projekti "Fuqizimi i imazhit te Visit Gjirokastra permes rrjetezimit publik-privat, permiresimit te sherbimeve, produkteve turisike dhe marketingut aktiv"	Visit Gjirokastra
12	Projekti "Nga Antikiteti ne Artin Bashkekohor Shqiptar"	Platforma e Artit Bashkekohor HARABEL
13	Projekti "Menaxhim destinacioni, Lugina e Lumit Kir"	Shoqata Argonaut
14	Projekti "Shqiperia ne 1 minute"	Qendra TI
15	Projekti "Hos-Cos Albania"	Qendra Shqiptare per nje zhvillim te qendrushem Tirane
16	Projekti "ZA Fest edicioni i VI"	Vlashent Sata PF
17	Projekti "Gjirokastra Tourism"	Shoqata South Albania Tourism and Heritage
18	Projekti "Sherbejme ndryshe ne Turizem"	Fondacioni Tradita Popullore
19	Projekti "Smart Tourism for All"	Qendra Youthfull
20	Projekti "Gjirokastra mirepret:"	TID Gjirokastra
21	Projekti "Karaburuni, destinacion turistik"	SkySports Albania shpk
22	Projekti "Kostumografia dhe Femijet"	Lizeta Hatika
23	Projekti "Festivalin e Vererave"	Bashkia Berat
24	Projekti "Etno-Explore Tirana"	Etno Tour Albania
25	Projekti "Nje guide televizive per Shqiperine Turistike te cdo stine"	Qendra Media dhe Ceshtjet Shoqerore
26	Projekti "Harta Digjitale e Shqiperise qytetet UNESCO Faza e pare"	Block & Roll Albania
27	Projekti "VISIT, love and care for Albania Gadgets"	Glon Bakalli
28	Projekti "Organizimi i eventeve kulturore ne Zonen e Konispolit"	Forest Lake shpk

29	Projekti "Bed & Bike Librazhd (Krevat & Bicikleta)"	Shoqata "Dhurojme ide"
30	Projekti "Shkoder Locka"	Qendra ISO
31	Projekti "Gjirokastra in your pocket-Shkodra in your pocket"	Landways International shpk
32	Projekti "Te ecim permes Bukurive te natyres, kultures dhe trashegimise"	Shoqata Nucleus Albania
33	Projekti "Take up an Iso"	Media Mix shpk
34	Projekti "Peza Adventure Festival"	Organizata Njerez dhe Ide
35	Projekti "Uncovering albanian Beauties-Water tours 2022"	Albanian Water Sports and Tourism
36	Projekti "Who would have thought? Albania"	Caravan Creative Agency shpk
37	Projekti "Shqiperia ne nje makine"	Albas shpk
38	Projekti "Vjosa n'Fest"	Shoqata Tirana Ekspres
39	Projekti "Turizmi ne tre dimensione- promovimi i turizmit te qendrueshem ne Qarkun e Vlores nepermjet dizenjimit dhe perjetimit virtual 360 te tureve unike ne HUB-in e Turizmit Vlore"	Biznes Albania

Ne thirrjen e dyte jane shpallur fitues 10 projekte (sipas tabelës së më poshtme), prej të cilëve 9 janë realizuar dhe 1 është tërhequr:

Nr.	Projekti	Kontrata/ subjekti perfitues
1	Aplikacioni Explore Albania	Celesi sh.p.k.
2	Promovimi i potencialeve turistike te zones se Ishmit	Culture is Us
3	Turizmi, pasuria e Verilindjes se Shqiperise	Qendra e Zhvillimit Shqiptar
4	Promovimi i astroturizmit ne fshatin Fushe Studen	Instituti per konsulenca dhe Kerkime
5	Shqiperia ne syte e mi	ProSafety sh.p.k.
6	Analize dhe vleresim per ecurine e sektorit te turizmit ne Shqiperi per vitin 2022 dhe krijimi i nje platforme te integruar baze te turizmit, mbeshetur ne te dhenat primare dhe sekondare	IDRA sh.p.k.
7	HOMELAND II	Fation Plaku
8	Tourism Knackathon	Innovation Management Academy Albania
9	Check in Fest Albania	PIK sh.p.k.
10	Elbasani Turistik	Zalav

Të ardhurat e Ministrisë

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, Ministria mbledh të ardhura për llogari të Thesarit të Shtetit për dhënien e lejeve mjedisore, liçencave, autorizimeve, tarifave vjetore, guida turistike, transit dhe eksport mbetje jo të rrezikshme. Këto të ardhura për vitin 2022 janë **87,527,584 lekë**.

Detyrimet e Prapambetura

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka detyrime të prapambetura, pasi detyrimet që lidheshin me individët e larguar nga puna janë shlyer brenda vitit 2022.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Ledina BEQIRAJ AGALLIU

